

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

**Auditimi i avancuar dhe
siguria**

P10

Data 30/10/2021

Detyra 1

Është prilli i vitit 2021 dhe ju jeni Labi, senior i auditimit që punon për Audit & Co. i cili do të drejtojë ekipin e punës në terren për auditimin e Kopshtet Shpk.

Menaxheri juaj, Laura, ju ka ofruar informatat në vijim:

“Përshëndetje Labi, ky është viti i parë që do të auditojmë pasqyrat financiare të Kopshtet. Ato u audituan për disa vite nga një firmë tjetër që është mbyllur së fundmi pas daljes në pension të partnerëve të tyre. Ne kemi përfunduar procedurat e pranimit para angazhimit dhe nuk kemi gjetur asnjë arsye për të mos pranuar emërimin si auditorë për vitin e mbyllur më 31 mars 2021.”

Laura gjithashtu ju dha informacionin e mëposhtëm:

Kopshtet operon një zinxhir prej 25 qendrash kopshtesh me pakicë në të gjithë shtetin, duke furnizuar klientët me pemë dhe bimë, si dhe produkte të ngjashme të kopshtarisë, të tilla si kositëse bari, mjete dhe pesticide.

Drejtori menaxhues, Meritoni, tha së fundmi, “Edhe pse COVID-19 ka goditur shumë biznese shumë rëndë, ne kemi qenë shumë të suksesshëm. Kufizimet e qeverisë, bllokimi dhe moti i mrekullueshëm në Pranverë/Verë 2020 rezultuan që njerëzit të kalonin më shumë kohë në shtëpitë dhe kopshtet e tyre. Jemi të kënaqur me rezultatet tona për vitin aktual financiar.”

Bimët dhe pemët janë blerë, gati për shitje, nga një sërë furnizuesish të specializuar në Kosovë dhe Evropë. Furnizuesit në Kosovë faturojnë Kopshtet në Euro. Klientët paguajnë për blerjet duke përdorur para të gatshme ose karta debiti/kredi. Kopshtet kreu një numërim të plotë të stoqeve në çdo qendër kopshti më 31 mars 2021, ku ishin të pranishëm përfaqësues nga Audit & Co.

Punonjësit në çdo qendër kopshtesh përfshijnë staf të përhershëm kopshtarie, i cili mirëmban pemët dhe bimët e disponueshme për shitje, dhe staf të përhershëm të shitjes me pakicë dhe shërbime ndaj klientit. Gjithashtu, një numër i madh i stafit të përkohshëm janë punësuar në periudhën prill-shtator për shkak të rritjes së vëllimit të shitjeve në këtë periudhë.

Në korrik 2020, drejtorët filluan punën e ndërtimit për të rritur madhësinë e qendrave të tyre të kopshtit për të përballuar kërkesën në rritje dhe kërkesat e distancimit social. Si rezultat i natyrës shumë sezonale të biznesit, drejtorët morën një kredi bankare në shtator 2020 për të siguruar para të mjaftueshme për të vazhduar punimet e ndërtimit gjatë muajve të dimrit, nëntor 2020 - mars 2021.

Kredia bankare është e ripagueshme për pesë vjet me interes të pagueshëm tremujor në fund të tremujorshit me normë 5.25%. Kredia bankare ka marrëveshje të rrepta të bashkangjitura dhe, nëse ka një shkelje, kredia mund të kthehet menjëherë.

Drejtori menaxhues, Meritoni, dëshiron ta zgjerojë biznesin edhe më tej, dhe do të donte të diversifikonte biznesin në shtator 2021, duke futur një sallë ushqimi dhe dyqan dhuratash në çdo qendër kopshti. Ai beson se kjo do të ndihmojë në uljen e ndikimit të sezonalitetit pasi këto produkte do të jenë më të njohura për klientët nga tetori deri në dhjetor të çdo viti. Për të financuar diversifikimin e propozuar, një kërkesë e re për kredi është dorëzuar në bankën e kompanisë. Banka dëshiron të ekzaminojë pasqyrat financiare të audituara për vitin e mbyllur më 31 mars 2021, së bashku me parashikimet e fitimit dhe rrjedhës së parasë në lidhje me diversifikimin e propozuar, për tre vitet që përfundojnë më 31 mars 2024.

Kopshtet ka miratuar një politikë rivlerësimi sipas SNK 16, dhe kryen një vlerësim të pasurive joqarkulluese në baza vjetore. Çështja që do të kërkojë më shumë punë audituese është vlerësimi i pronave aktualisht në zhvillim, veçanërisht përcaktimi i përqindjes së përfundimit të çdo zhvillimi në datën e raportimit. Sipas auditorit të mëparshëm, një vlerësues i jashtëm ishte angazhuar për të vlerësuar pronat në datën e raportimit. Megjithatë, Kopshtet ka punësuar së fundmi një arkitekt të sapokualifikuar, i cili do të jetë i lumtur të ofrojë dëshmi në lidhje me fazën e përfundimit të secilës kontratë për zhvillimin e pronës në datën e fundit të vitit të raportimit financiar. Përdorimi i këtij arkitekti për të prodhuar një raport mbi të gjitha pronat në zhvillim do të kursejë kohë dhe kosto.

Në janar 2021, Kopshtet lançoi një uebsajt të ri që lejon klientët të blejnë produkte në internet. Drejtoresha e financës, Lisa, shpjegoi se kompania ka shpenzuar para të konsiderueshme në TI (teknologji informative) këtë vit. Kompania ka zhvilluar faqen e saj të internetit dhe ka

përditësuar sistemet e TI-së në mënyrë që të integrojë shitjet nga faqja e internetit drejtpërdrejt në librin kryesor dhe të sigurojë një ndërfaqe më të lehtë për klientët që ta përdorin kur porosisin dhe futin detajet e kartës së tyre të kreditit. Megjithatë, Lisa shprehu shqetësimin se sistemi TI nuk do të jetë në gjendje të përballojë presionin e shtuar të faqes së internetit, pasi së fundmi ka shkaktuar disa dështime të mëdha të sistemit, me pasojë humbjen e klientëve. Detaje të mëtejshme jepen në Shtojcën 1.

Drejtori menaxhues, Meritoni, i dërgoi draftin e pasqyrave financiare menaxheres së auditimit, Laura. Laura jua ka përcjellë ato (shih Shtojcën 2) dhe ju ka kërkuar që të filloni seksionin e planifikimit të dosjes së auditimit.

Shtojca 1: Dështimet e sistemit IT

- (i) Sistemi prodhon informacione menaxheriale të cilat shpesh janë të pasakta. Fatkeqësisht, jo gjithmonë e kemi vënë re se ishin të pasakta dhe vendimet janë bazuar në këtë informacion, veçanërisht në blerjen e produkteve. Ne përfunduar duke blerë stoqe në tepricë, kështu që u desh të ulnim çmimet për të pastruar stoqet.
- (ii) Ditën e lansimit së faqes së internetit, disa pjesë të faqes së internetit nuk funksionuan dhe klientët u hutuan. Çështja mori një muaj për t'u zgjidhur. Furnizuesi i softuerit është tani në likuidim, duke na lënë pa një kontratë mirëmbajtjeje.
- (iii) Dje, ne humbëm lidhjen tonë me internetin për shkak të një virusi dhe duhej t'i drejtoheshim back-up it tonë (kopjes rezervë), të cilat fatkeqësisht ishin të korruptuara. Të dhënat definitivisht kanë humbur, përfshirë porositë me furnitorët, megjithëse ne kemi rifutur disa të dhëna.
- (iv) Raporti ynë i menaxhmentit identifikoi një numër rregullimesh të mëdha në stoqe. Nuk jam i sigurt se kush i ka bërë rregullimet, pasi çdo anëtar i stafit ka qasje në sistem. Jemi të kujdesshëm kur një punonjës largohet t'i heqim nga sistemi brenda një muaji, ndaj rregullimet me siguri janë bërë nga një punonjës aktual.
- (v) Jam i vetëdijshëm se nuk po përdorim të gjithë funksionalitetin e sistemit dhe se ai mund të bëjë më shumë dhe të japë më shumë informacion, por për shkak të problemeve të hasura më sipër, ne aktualisht po e përdorim sistemin vetëm kur kemi nevojë.

Shtojca 2 – Pasqyrat financiare të Kopshtet Shpk

Pasqyra e të ardhurave

Për vitin që përfundoi me 31 mars 2021

	2021	2020
	€'000	€'000
Të hyrat	172,656	128,577
KMSH	(109,499)	(90,005)
Fitimi bruto	63,157	38,572
Pagat	(18,716)	(11,265)
Shpenzimet administrative	(30,615)	(18,345)
Kostot financiare	(389)	
Fitimi para tatimit	13,437	8,962

Pasqyra e pozicionit financiar

Për vitin e mbyllur me 31 mars 2021

	2021	2020
	€'000	€'000
Pasuritë joqarkulluese	29,434	16,434
Pasuritë e patrupëzuara	235	
Pasuritë qarkulluese	10,500	6,165
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	121	239
Të arkëtueshme tjera	87	24
	10,708	6,428
Pasurtë gjithsej	40,377	22,862
Detyrimet afatshkurta		
Llogaritë e pagueshme	9,278	8,956
Të pagueshme tjera	144	98
Huazime	3,000	
	12,422	9,054
Detyrimet afatgjata		
Huazimet	12,000	
Gjithsej detyrimet	24,422	9,054
Pasuritë neto	15,955	13,808
Ekuiteti	15,955	13,808

Kërkohet:

(a) Duke përdorur informatat e ofruara:

(i) Përgatitni procedurat analitike të detajuara të pasqyrave financiare. **(5 pikë)**

(ii) Listoni informatat dhe pyetjet shtesë që do të kërkoni si rezultat i procedurave analitike (varësisht nga luhatjet e identifikuar) **(10 pikë)**

(c) Identifikoni dhe shpejgoni GJASHTË fusha me rrezik të auditimit lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të Kopshtet ShPK. **(12 pikë)**

(d) Analizoni rreziqet kyçe që kanë të bëjnë me sistemet e TI të paraqitura në Shtojcën 1 dhe rekomndoni kontrollet përkatëse. **(8 pikë)**

[Total: 35 pikë]

Zgjidhja

	2021		2020	Levizjet
	€'000		€'000	
Të hyrat	172,656		128,577	34.28%
KMSH	-109,499		-90,005	21.66%
Fitimi bruto	63,157	36.6%	38,572	30.0% 63.74%
Pagat	-18,716	-10.8%	-11,265	8.8% 66.14%
Shpenzimet administrative	-30,615	-17.7%	-18,345	14.3% 66.88%
Kostot financiare	-389	-0.2%		0.0% 49.93%
Fitimi para tatimit	13,437		8,962	
	2021		2020	
	€'000		€'000	
Pasuritë joqarkulluese	29,434		16,434	79.10%
Pasuritë e patrupëzuara	235			
Pasuritë qarkulluese	10,500		6,165	70.32%
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	121		239	-49.37%
Të arkëtueshme tjera	87		24	262.50%
	10,708		6,428	66.58%
Pasurtë gjithsej	40,377		22,862	76.61%
Detyrimet afatshkurta				
Llogaritë e pagueshme	9,278		8,956	3.60%
Të pagueshme tjera	144		98	46.94%
Huazime	3,000			
	12,422		9,054	37.20%
Detyrimet afatgjata				
Huazimet	12,000			
Gjithsej detyrimet	24,422		9,054	169.74%
Pasuritë neto	15,955		13,808	15.55%
Ekuiteti	15,955		13,808	15.55%

Pyetje dhe dëshmi shtesë:

	Pyetje/intervista	Evidenca/dëshmi
Të hyrat	<p>Pse janë rritur të hyrat me 34%?</p> <p>Cilat janë procedurat për regjistrimin e shitjeve?</p> <p>Çfarë % të të hyrave janë online?</p>	<p>A mund të ofroni ndarjen e të hyrave për product</p> <p>A mund të ofroni ndarjen e të hyrave sipas qendrave</p> <p>A mund të ofroni procedurat e kontrollit mbi procesin e shitjeve</p>
Fitimi bruto	<p>Pse është rritur marzha e fitimit brutor nga 30% në 37%</p> <p>Pse janë rritur shitjet me 34% por KMSH është rritur vetëm me 21.66% - pse nuk përputhen?</p> <p>A është rritja si rezultat i:</p> <p>Marzhës më të lartë të mallrave</p> <p>Efektit të lëvizjes së norma të këmbimit</p> <p>Furnizime më të lira</p> <p>Nënvlerësim i mundshëm i blerjeve</p> <p>Mbivlerësim i mundshëm i stoqeve</p>	<p>A mund të na ofroni ndarjen e KMSH</p> <p>A mund të na ofroni tabelën e ndarjes me çmime të shitjes për product dhe koston përkatëse</p>
Shpenzimet	<p>Pse janë rritur pagat me 61.44%</p> <p>A keni punësuar punonjës të ri gjatë vitit</p> <p>A është paguar ndonjë bonus gjatë vitit</p> <p>Pse janë rritur shpenzimet administrative me 66.88%</p>	<p>A mund të na ofroni informatat në vijim:</p> <p>Raportin e pagave për vitin</p> <p>Detajet e punonjësve të rinj dhe punonjësve që janë larguar gjatë vitit</p> <p>Punonjësit e përkohshëm</p> <p>Detajet e bponuseve të paguara</p> <p>Detajet e shpenzimeve administrative</p>
Huaja/kredia	<p>Cilat janë kushtet e kredive</p> <p>A i keni respektuar këto kushte</p>	<p>A mund të na ofroni:</p> <p>Kontratat e kredive dhe pagesat e kësteve</p>
Pasuritë joqarkulluese	<p>Cilat janë shtesat gjatë vitit</p> <p>Cilat janë shitjet gjatë vitit</p>	<p>A mund të na ofroni regjistrin e pasurive përfshirë shtesat dhe shitjet</p> <p>Detajet e ndërtesës së re</p> <p>Kopjen e vlerësimeve në fund të vitit</p>
Pasuritë e patrupëzuara	<p>Nga çka përbëhen pasuritë e patrupëzuara</p>	<p>A mund të na ofroni detajet e kesaj llogarie së bashku me shtesa</p>
Pasuritë qarkulluese	<p>Nga çka përbëhen pasuritë qarkulluse - ndarjen në mes të LLA dhe stoqeve?</p>	<p>A mund të na ofroni listën e stoqeve dhe të LLA</p>

		A mund të na ofroni numërimin fizik të stoqeve në fund të vitit Listën e moshimit të LLA
Banka	Pse është zvogëluar saldo e ban kës me 50%	A mund të na ofroni harmonizimet bankare në fund të vitit Ekstraktet e bankës për periudhën
Të arkëtueshme tjera	Ose jaën rritur kaq shumë të arkëtueshmet tjera	A mund të na ofroni një lsisë të ndarjes së LLA të tjera
Llogaritë e pagueshme	Pse janë zvogëluar ditët e të pagueshmeve nga 36 në 31 ditë A i harmonizoni kartelat e furnitorëve me shënimet tuaja kontabël A është ky zvogëlim si rezultat i Nënvlërësimit të të pagueshmeve për shkak të faturave të paregjistruara Kushteve më strikte të pagesës Brenda afatit Gabimeve në përkthime valutore	Na ofroni: Listën e moshimit të LLP Korrespondencat me furnitorët, përfshirë kartelat e pranuar të furnitorëve

b)

Rreziku i auditimit	Shpjegimi dhe procedurat
Auditimi i vitit të parë - ekzistenca dhe saktësia e saldove fillestare	Kompania është klient i ri i auditimit prandaj firma ka mungesë të njohurisë për klientit. Është vështirë të përftohet siguri mbi saldot fillestare Rishikoni dosjet e vitit të kaluar, kryeni teste shtesë për të siguara dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit për këto saldo
Rreziku i këmbimi valuator	Blerjet janë bërë me valutë të huaj. Ka rrezik që entiteti nuk është në pajtueshmëri me trajtimin e këtyre transaksioneve në pajtueshmëri me SNK 21.
Pasuritë joqarkulluese - pasuritë në ndërtim	Duhet të sigurohemi se nuk ka shpenzime të njohura në paqyrën e të ardhurave për ato që duhej të kapitalizoheshin Duhet të sigurohemi se pasuritë në ndërtim nuk janë duke u zhvlerësuar ende.
Vlerësimi i pronave / shkalla e kompletimit	Është e arsyeshme të angazhohet një ekspert. Në rastin e angazhimit të ekspertit, auditori duhet të vlerësojë kompetencën, aftësitë dhe objektivitetin e ekspertit

	<p>Arkitekti është i rid he kjo mund të hedhë dyshime mbi mjaftueshmërinë e kompetencës dhe përvojës për të kryer punën.</p> <p>Arkitekti është i punësuar nga entiteti prandaj mund të mos jetë objektin në vlerësim</p>
Stoqet	<p>Ditët e stoqeve janë rritur nga 25 në 35 që mund të sugjeroj se ka stoqe të dala jasht përdorimit ose të dëmtuara,</p> <p>Produktet blihen jasht vendit dhe faturohen me valutën vendore. Disa lloje të produkteve mund të jetë e vështirë të njihen për shkak të natyrës së tyre prandaj mund të jetë e nevojshme angazhimi i ekspertit që njeh bimët dhe pemët</p> <p>Gjithashtu kompania ka blerë stoqe ne tepricë të cvilar duhet ti shes me çmim të zbritur – kjo mund të sugjeroj që stoqet nuk mbahen në pajtueshmëri me SNK2</p>
Huaja bankare	<p>Rreziku që huaja nuk është regjistruar saktë dhe është klasifikuar gabimisht</p> <p>Shpenzimet e interest nuk janë llogaritur dhe paraqitur si duhet</p> <p>Gjithashtu huatë bankare mund të kenë kushte strikte -të cilat nëse nuk plotësohen mund të shkaktojë që huaja të tërhiqet nga banka</p>
Të hyrat	<p>Biznesi është i bazuar në para që ka rrezik të mosregjistrimit të duhur të të hyrave në para të gatshme</p> <p>Mirëpo pasi që të hyrat janë rritur me 34% kjo mund të tregoj për mbivlerësim të tyre</p>
Blerjet dhe LLP	<p>Ditët e LLP kanë rënë 36 në 31 ditë dhe marzha e fitimit bruto është rritur nga 30 në 36% që mund të jetë tregues për nënvlerësim të blerjeve dhe LLP</p>
Rreziku i kontrollit	<p>Kompania punëson numër të madh të personelit të përkohshëm që mund t ërezultoj me gabime njerëzore dhe dështim për të kuptuar procedurat e kontrollit të brendshëm</p>
Shitjet përmes internetit	<p>Ka rrezik që faqja e internetit të mos arrijë të përballoj kërkesat</p> <p>Ka rrezik të prerjes sepse me shitjet online ndonjëherë është e vështirë të caktohet data e saktë e transaksionit</p>
Hipoteza e vijimësisë	<p>Kompania ka pasur rritje domethënëse</p> <p>Biznesi është sezonal që mund të shkaktoj vështirësi me rrjedhën e parasë</p> <p>Biznesi mbështetet shumë në kredi dhe rritja e këtyre kredive mund të shkaktoj probleme me rrjedhë të parasë</p>

Dobësitë në sistemin e TI

Dobësia	Kontrollet e rekomanduara
Mungesë e informative të besueshme nga sistemi	Sistemi duhet të testohet para se të implementohet dhe i gjithë stafi duhet të trajnohet
Humbja në mirëmbajtjen e softuerëve mund të shkaktojë humbje në përdorim të tyre	Furnitori do të duhej të aprovohej nga bordi dhe të konsiderohej koha e furnizimit Duhet të kërkohet një furnitor tjetër
Humbja e interentit për shkak të virusëve mund të shkaktoj humbje të porosive	Kompjuterët duhet të azhurnohen me anti-virus
Nuk janë kontrolluar kopjet rezervë (backup)	Kopjet rezervë duhet të bëhen në baza të rregullta
Humbja e konsumatorëve për shkak të faqes së dobët të internetit	Duhej të kishte zhvillim të duhur të faqes së internetit, testim të sistemit para lansimit

Detyra 2

Ju jeni një menaxher auditimi në firmën ligjore të auditimit Fiti.

Ju jeni duke punuar me klientët e mëposhtëm dhe partneri i angazhimit të auditimit ju ka kërkuar të vlerësoni situatat e mëposhtme të klientit:

Aqua ShPK (Aqua)

Aqua ka qenë klient i firmës suaj prej disa vitesh. Draft pasqyrat financiare tregojnë se fitimi i Aqua para tatimit është 3.1 milionë euro. Përpara fundit të vitit, Aqua mori korrespondencë ligjore në të cilën thuhej se po paditet për shkelje të kontratës me një klient të rëndësishëm. Klienti kërcënon të kërkojë dëmshpërblim prej 6.5 milionë euro. Ekipi i auditimit ka shqyrtuar korrespondencën dhe ka marrë konfirmimet ligjore nga avokatët e Aqua. Avokatët e Aqua deklaruan se, për shkak të subjektivitetit të çështjes, ata nuk janë në gjendje të konkludojnë nëse ka gjasa që Aqua të fitojë apo të humbasë çështjen. Prandaj, Aqua nuk ka bërë asnjë provizion në pasqyrat financiare; megjithatë Aqua ka bërë shënime përkatëse. Partneri i angazhimit pajtohet me trajtimin kontabël dhe është i kënaqur që shënimi përfshin të gjithë informacionin e nevojshëm që përdoruesit e pasqyrave financiare të kuptojnë situatën.

Bongo ShPK (Bongo)

Firma juaj është auditori i jashtëm i Bongo-s për vitin e përfunduar më 28 shkurt 2021. Bongo është një shitës me pakicë veshjesh dhe mban një sistem të vazhdueshëm për stoqet të cilin e përdor për të llogaritur vlerën e stoqeve në fund të vitit. Në mars 2021, një virus kompjuteri korruptoi të dhënat e mbajtura në sistemin e stoqeve duke rezultuar në humbjen e të dhënave në lidhje me vlerën e stoqeve më 28 shkurt 2021. Drejtori financiar ishte përgjegjës për marrjen e kopjeve rezervë. Megjithatë, ai ishte shumë i zënë me përgatitjen e pasqyrave financiare në fund të vitit dhe harroi të bënte një kopje rezervë. Kopja e fundit rezervë në dispozicion ishte e datës 23 dhjetor 2020. Drejtorët kanë vlerësuar vlerën e stoqeve në fund të vitit të jetë 1.95 milion €; megjithatë, ata nuk janë në gjendje të ofrojnë dokumentacion të përshtatshëm për ta mbështetur këtë. Fitimi para tatimit sipas draft pasqyrave financiare është 15.4 milion €.

Uini ShPK (Uini)

Ju pothuajse keni përfunduar auditimin e jashtëm të Uini për vitin e përfunduar më 31 janar 2021.

Sidoqoftë, pas përfundimit të rishikimit të ngjarjeve pasuese, ju vutë re një letër të datës 1 mars 2021 nga administratori i Mona ShPK, një klient i Uini. Nga letra mund të shihni se Mona është në administrim dhe nuk do të jetë në gjendje të paguajë bilancin prej 785,000 € që i kishte borxh Uinit më 31 janar 2021. Drejtorët në Uini janë këmbëngulës të mos bëjnë një provizion për këtë saldo, pasi që janë duke u mbështetur nga një kredi nga banka, dhe një provizion i borxhit të keq do të ulë ndjeshëm fitimin e tyre. Draft pasqyrat financiare të Uini për vitin e përfunduar më 31 janar 2021 tregojnë një fitim para tatimit prej 3.9 milionë euro dhe pasuri totale prej 28.3 milionë euro. Drejtorët thanë gjithashtu, “edhe ashtu ne nuk pranuan letrën deri në fund të vitit, kështu që nuk ka nevojë për një provizion”.

Kërkohet:

- (a) Vlerësoni në mënyrë kritike ndikimin e mundshëm të ngjarjeve të mësipërme në raportin e auditorit. **(12 pikë)**
- (b) Përshkruani mënyrat se si auditorët mund të kufizojnë përgjegjësinë dhe veprimet që duhet të ndërmerren për të zvogëluar rrezikun e padisë nga palët e treta. **(13 pikë)**

[Total: 25 pikë]

Zgjidhja

(a) Aqua

- Kërkesa është materiale pasi është 209% e fitimit para tatimit.
- Ekziston një pasiguri materiale, megjithatë nuk ka kufizim të fushëveprimit.
- Pretendimi është thelbësor për të kuptuar përdoruesit e pasqyrave financiare, si një pretendim i suksesshëm do ta kthente fitimin e Aqua në humbje.
- Prandaj, raporti i auditimit duhet të modifikohet duke përdorur një paragraf të pa[sigurisë materiale dhe në] shënim në pasqyrat financiare duhet të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në shënimin përkatës të shpalosjes. Opinioni nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Bongo

- Vlera e stoqeve është materiale pasi është 12.66% e fitimit para tatimit.
- Opinioni duhet të modifikohet për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme të përshtatshme audituese – Kufizimi i fushëveprimit.
- Çështja nuk është e përhapur pasi është e izoluar në bilancin e stoqeve.
- Auditori duhet të japë një opinion të kualifikuar ('përveç').

Uini

- Marrja e një letre nga administratori i Mona jep dëshmi të kushteve ekzistuese në në fund të vitit dhe për rrjedhojë është një ngjarje pasuese korrigjuse sipas SNK 10. Shuma e detyrimit nga Mona duhet shlyer.
- Shuma është 20.13% e fitimit para tatimit dhe 2.77% e totalit të pasurive dhe për rrjedhojë është materiale.
- Duhet të lëshohet një raport/opinion i modifikuar i auditorit për shkak të anomalive materiale.
- Çështja nuk është e përhapur pasi ajo prek vetëm zëra të veçantë në pasqyrat financiare dhe për këtë arsye duhet të jepet një opinion i kualifikuar ('përveç').

b)

Auditorët mund të përdorin disa veprime për të kufizuar përgjegjësitë e tyre:

Paragrafët që kufizojnë përdorimin e raporteve të auditorit – auditorët përpiqen të mbrohen përpes këtyre veprimeve në rastet kur ata nuk e dinë se një palë e tretë do të mbështetet mbi punën e tij, por kujton se kjo është një punë e tillë, mbi të cilën palët e treta mund të mbështeten vetëm nëse nuk ndërmerren asnjë lloj veprimesh të tjera, të ndryshme nga veprimet e zakonshme që kryen kompania.

Aspekte të tjera të mënyrës se si firmat përpiqen të merren me çështjet gjyqësore është strategjia që ato ndjekin për të shmangur çështjet gjyqësore. Kjo strategji ka aspekte të shumta.

- **Procedurat e pranimit të klientit** janë shumë të rëndësishme, sidomos ekzaminimi i klientëve të rinj dhe përdorimi i letrave të angazhimit..
- **Kryerja e punës së auditimit.** Firma duhet të sigurohet se të gjitha auditimet kryhen në përputhje me standardet profesional dhe praktikat më të mira.

- **Kontrolli i cilësisë.** Këtu nuk përfshihen vetëm kontrollet e bëra për auditimet individuale por, në të njëjtën kohë edhe procedurat më rigorozë që zbatohen në nivel kompanie.
- **Vendosja e paragrafëve të duhur të cilët kufizojnë përdorimin e raporteve të auditorit.** Rëndësinë e kësaj pike e diskutuam më lart.

Mënyra më e mirë e kufizimit të detyrimeve është që auditorët të kryejnë punën e tyre të auditimit në përputhje me Standardet e Auditimit. Në rast se puna kryhet siç duhet, auditori nuk ka nevojë të vendosë paragrafët boshë që kufizojnë përdorimin e raporteve të auditorit.

Detyra 3

Ju jeni një menaxher i auditimit në firmën Morea & Partnerët. Ju jeni përgjegjës për auditimin e Katërsia ShPK, një prodhues dhe shitës me pakicë i pajisjeve elektrike. Auditimi përfundimtar për vitin e përfunduar më 28 shkurt 2021 është drejt përfundimit dhe ju jeni duke shqyrtuar dokumentet e punës së auditimit. Draft pasqyrat financiare paraqesin pasuri totale prej 215 milionë euro (2020 - 208 milionë euro), të hyra prej 165 milionë euro (2020 - 148.4 milionë euro) dhe fitimin para tatimit prej 41 milionë euro (2020 - 56.4 milionë euro). Tri çështje nga dokumentet e punës së auditimit janë përmbledhur më poshtë:

Provizioni i garancisë së produkteve

Çdo vit, menaxhmenti bën një parashikim për pajisjet elektrike të kthyer nën garanci. Ai bazohet në një vlerësim të niveleve të kthimit për çdo lloj produkti (makina larëse, frigoriferë, furra, televizorë etj.) dhe llogaritet në baza vjetore nga drejtori i shitjeve. Zbërthimi për provizionin aktual, i nxjerrë nga shënimet e pasqyrave financiare, është si më poshtë:

	€ milion
Me 1 mars 2020	9.5
Provizionet e ngarkuara gjatë vitit	1.5
Provizionet e përdorura gjatë vitit	(1.9)
Provizionet e papërdorura të kthyer në pasqyra	(1.1)
Me 28 shkurt 2021	8.0

Stoqet

Stoqet në pasqyrat financiare me 28 shkurt 2021 kanë vlerën prej 9,350,000 €.

Tre anëtarë të ekipit të auditimit morën pjesë në numërimin e stokeve më 28 shkurt 2021. Ju keni rishikuar tashmë punën e auditimit të përfunduar në lidhje me numërimin e stokeve dhe nuk keni identifikuar ndonjë problem. Për shkak të kufizimeve të qeverisë në Mars 2021, Kaltërsia ShPK vendosi të ketë shitje online, duke u dhënë të gjithë klientëve 30% zbritje të të gjitha produkteve. Drejtori i financave tha se ishte e rëndësishme të shitej i gjithë stoku ekzistues përpara se të mbërrinte stoku i ri. Drejtori i financave gjithashtu deklaroi se ishte i sigurt se kompania do të ishte në gjendje të shesë të gjitha stoqet dhe nuk kërkohej një provizion në fund të vitit.

Pasuritë joqarkulluese

Në shqyrtimin e procesverbalit të takimeve të bordit, ju shihni se, në dhjetor 2020, kompania vendosi të shesë disa nga njësitet e saj të shitjes me pakicë. Ata janë aktualisht në treg për shitje, dhe menaxhmenti shpreson për një shitje të shpejtë. Pasuritë joqarkulluese prej 16,500,000€ janë klasifikuar si të mbajtura për shitje në fund të vitit. Nga diskutimet me drejtorin financiar, vlera e drejtë e pasurive joqarkulluese minus kosto e shitjes është 13,250,000€.

Kërkohet

(a) Lidhur me secilën çështje: In respect of each of the three issues:

(i) Përshkruani dëshmitë e auditimit që kërkohet për të përfunduar rishikimin e dosjes së auditimit. **(18 pikë)**

(ii) Përgatitni regjistrimet në ditar për anomalitë e pakorrigjuara që keni identifikuar në skenar. **(3 pikë)**

(b) Në pajtueshmëri me SNA 560 - Ngjarjet pasuese, përshkruani procedurat e auditimit të cilat duhet të kryhen nga auditori para nënshkrimit të raportit. **(4 pikë)**

[Total: 25 Pikë]

Zgjidhja

(i) Provizionet e garancisë:

- Provizionet e fundvitit përfaqësojnë 3.72% të totalit të pasurive dhe 19.51% të fitimit. Prandaj është materiale për pasqyrat financiare.
- Vlerësimi i kthimeve i nënshtrohet qartësisht subjektivitetit. Kjo rrit rrezikun e anomalisë materiale për shkak të gabimeve dhe mashtrimeve.
- Drejtori i shitjeve vlerëson kthimet e bëra; megjithatë kjo mund t'i përshtatet më mirë dikujt si p.sh menaxheri të të prodhimi/menaxherit të kontrollit të cilësisë. Një menaxher i kontrollit të cilësisë mund të jetë i vetëdijshëm për gabimet në pajisje

Dëshmitë që priten të gjenden në dosje:

- Kopjet e kontratave të shitjes me klientët, përfshirë detajet e termave dhe kushteve dhe kohëzgjatjen e periudhës së garancisë.
- Diskutimet me drejtorin e shitjeve, për të kontrolluar supozimet e bëra, dhe llogaritjet e tyre.
- Diskutime me menaxherin e prodhimit/menaxherin e kontrollit të cilësisë për të parë nëse kthimet e vlerësuara janë të arsyeshme, dhe nëse ka ndonjë çështje të njohur në lidhje me mallrat e shitura.
- Një kopje e llogaritjes së provizionit të garancisë. Ekipi i auditimit duhet të kishte kryer një analizë për të rishikuar dhe diskutuar çdo lëvizje të rëndësishme me vitet e mëparshme.
- Ekipi i auditimit duhet të kishte rillogaritur provizionin dhe të diskutonte çdo ndryshim.
- Ekipi i auditimit duhet të rishikojë llogaritjen e provizionit total të pashfrytëzuar të anuluar gjatë vitit, dhe diskutoni me menaxhmentin se përse nuk është më e nevojshme.

Stoqet:

- Stoqet kanë saldo materiale, pasi është 22.8% e fitimit para tatimit dhe 4.34% e totalit të pasurive.
- Stoqet janë një fushë me rrezik, pasi ne po shohim një prodhues elektrik, dhe për shkak të natyrës së biznesit, mallrat mund të vjetërohen. Ne e dimë që pas fundit të vitit, kompani vendosi të japë 30% zbritje në të gjitha produktet.
- Sipas SNK 2, stoqet duhet të paraqiten me koston më të ulët dhe NRV.

Dëshmitë që priten të gjenden në dosje:

- Lista e të gjithë artikujve të mbajtur në depo në fund të vitit dhe detajet e koston së tyre.
- Ekipi i auditimit duhet të ketë rillogaritur tabelat dhe të sigurohet se kostoja totale pajtohet me shifrën e 9,350,000€ të përfshira në Pasqyrën e Pozicionit Financiar.
- Ekipi i auditimit duhet të kishte diskutuar me Drejtorin/Menaxhmentin e Financës, pse ata besojnë se një provision nuk është i nevojshëm.
- Ekipi i auditimit duhet të marrë një mostër të stoqeve në fund të vitit. Ata duhet të përputhin koston origjinale me faturat e blerjes, dhe ata duhet të poërputhin me çmimin e shitjes së stoqeve për të verifikuar nëse mbahen me kosto ose VNR sipas SNK 2.
- Ekipi i auditimit duhet të diskutojë me menaxhmentin nëse stoku po shitet në shitje dhe të shikojë në dokumentacionin mbështetës (faturat e shitjes, pasqyrat bankare).

Pasuritë joqarkulluese

- Njësitë e shitjes me pakicë janë klasifikuar si pasuri të mbajtura për shitje në fund të vitit.
- Saldo është materiale, pasi është 40.24% e fitimit para tatimit dhe 7.67% e totalit të pasurive.
- Është e qartë se pasuritë janë klasifikuar saktë si pasuri të mbajtura për shitje, pasi ato plotësojnë kriteret e përcaktuara në SNRF 5
 - Menaxhmenti është i përkushtuar të shesë

- Pasuritë janë të disponueshme për shitje të menjëhershme në gjendjen e tyre aktuale
- Njësitë e shitjes me pakicë janë në treg dhe menaxhmenti po kërkon një shitje të shpejtë.
- Shitja është shumë e mundshme, pasi menaxhmenti është në kërkim të një shitje të shpejtë, prandaj duhet të shitet brenda 12 muajve.

Dëshmitë që priten të gjenden në dosje:

- Një kopje e procesverbalit të bordit, ku shënohet, kompania vendosi të shesë disa nga njësitë e saj të shitjes me pakicë.
- Dëshmi se njësitë e shitjes me pakicë janë tashmë në treg (broshurë nga agjentët e pasurive të patundshme/dëshmi në internet)
- Inspektimi fizik i pasurive për të konfirmuar se ato janë të shitshme në gjendjen aktuale.
- Përfaqësim me shkrim nga menaxhmenti për të konfirmuar se ata janë të përkushtuar për të shitur brenda 12 muajve.
- Detajet mbi vlerën bartëse të pasurive në 16,500,000€.
- Konfirmimi se zhvlerësimi ka pushuar me riklasifikimin e pasurive
- Dëshmi për të mbështetur vlerën e drejtë të pasurive minus koston e shitjes.
- Diskutimet me menaxhmentin për t'i bërë të vetëdijshëm se pasuritë e mbajtura për shitje duhet të maten sipas vlerës bartëse ose vlerës së drejtë minus koston e shitjes, cilado që është më e ulët, në këtë situatë është 13,250,000€.
- Prandaj, duhet të propozohet një regjistrim në ditar prej 3,250,000 € për të ulur vlerën e aseteve në vlerën e drejtë të aseteve minus koston e shitjes.

(ii) Regjistrimet në ditar

D. Dëmtimi 3,250,000

K. Pasuritë e mbajtura për shitje 3,250,000

b) Në pajtueshëri me SNA 560, auditori duhet të:

- Përftoj njohuri mbi procedurat e vendosura nga menaxhmenti për të siguruar se janë identifikuar ngjarjet pasuese
- Lexojë procesverbalet e takimeve të bordit pas fundit të vitit dhe pyes PNMQ për çfardo çështje e cila është përfshirë në procesverbale
- Diskutoj me menaxhmentin dhe PNMQ nëse ka ndodhur ndonjë ngjarje pasuese pas fundit të vitit
- Rishikoj raportet menaxheriale të entitetit përfshirë parashikimet errjedhës së parasë, buxhetet, etj

Detyra 4

Si pjesë e trajnimit, firma juaj e auditimit ju ka dhënë situatat e mëposhtme për vlerësim. Tri situata e mëposhtme janë të palidhura me njëra tjetrën për të vlerësuar çështjet profesionale dhe etike në secilin rast.

Atlanta ShPK (Atlanta)

Grant & Partnerët është auditori i jashtëm i Atlantës dhe filialeve të saj. Atlanta ka blerë së fundmi 100% e kapitalit aksionar të Chen ShA (Chen), një kompani që operon në Kinë. Drejtorët e Atlantës kanë kërkuar që Grant të pranojë emërimin si auditor i jashtëm i Chen dhe të ndërmarrë një angazhim të vetëm për të rishikuar dhe raportuar mbi përshtatshmërinë e kontrolleve të brendshme në Chen. Tarifa vjetore e auditimit të Grant për grupin Atlanta pritet të rritet në 996,700 € nëse pranon emërimin si auditor i Chen. Tarifa për rishikimin dhe raportimin mbi kontrollet e brendshme në Chen pritet të jetë 175,000 €. Të ardhurat totale vjetore të tarifave të Grant pritet të jenë 7.56 milionë euro. Asnjë nga entitetet brenda grupit të Atlantës nuk është i listuar.

Nolan Shpk (Noli)

Partneri i angazhimit të auditimit ka zbuluar se, gjatë auditimit të jashtëm të Noli për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020, një anëtar i ekipit të angazhimit pranoi një orë të shtrenjtë si dhuratë nga Noli për punën e tij të palodhur gjatë auditimit. Raporti i auditorit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 është publikuar.

Endriti Shpk (Endriti)

Endriti është një klient kryesor auditimi i një firme të auditimit. Është e listuar në një bursë kryesore. Ekipi i auditimit përbëhet nga tetë anëtarë, nga të cilët Panajoti është më i riu. Panajoti sapo i është bashkuar një plani personal pensioni që investon në të gjitha kompanitë e listuara në Bursë.

Kërkohet:

(a) Hartoni një memorandum për menaxherin tuaj të auditimit, i cili identifikon dhe shpjegon çështjet profesionale dhe etike që dalin në secilën nga situatat e mësipërme. Tregoni çdo veprim që partnerët e secilës firmë ose punonjësit e tjerë të saj duhet të ndërmarrin për të adresuar këto çështje. **(15 pikë)**

[Totak: 15 pikë]

Zgjidhja

Çështjet etike dhe profesionale	Kërcënimi etik	Veprimet
Atlanta		
Tarifa përbën 13.2% të të hyrave totale të firms Kjo është mbi 10% por nën 15% Ka rrezik të mbimbështetjes në të hyrat nga Atlanta Auditori mund të mos jetë objektiv gjatë punës	Interesi vetiak	Firma duhet ti nënshtrohet rishikimit të kontrollit të cilësisë Firma duhet të përpiqet të rrisë bazën e klientëve për të zvogëluar varshmërinë në një klient
Angazhimi për të rishikuar kontrollat e brendshme kërkon që firma të merr vendime menaxheriale	Kërcënimi i menaxhimit	Firma nuk duhet të merr vendime menaxheriale për një klient të auditimit
Rezultatet e rishikimit të KB duhet të rishikohen gjatë auditimit Ka rrezik të kompetencës profesionale, prandaj duhet të konsiderohen: A kemi burime ose përvojë të mjaftueshme për të kryer angazhimin Të diskutohet me klientin për konfliktin e mundshëm Të kemi knjhuri të mjaftueshme të rregulloreve në atë jurudiksion	Kërcënimi i vetërishikimit	Duhet të ketë ekupe të ndara për këtë dy angazhime Firma duhet të siguroj se ka burime të mjaftueshme para pranimit të angazhimit
Nolan		
Ora përbën dhuratë dhe kërcënon objektivitetin e pranuesit Kjo përfaqëson mungesë të sjelljes profesionale	Interesi vetiak	Ora duhej të mos pranohej dhe ekipi i auditimit duhet të dicitlinohet Firma duhet të siguroj se anjë anëtarë i ekipit nuk pranon dhurata ose mikëpritje
Endriti		
Ka një kërcënim të interes vetiak për shkak të ingteresit indirect financiar Faktorët që duhet të konsiderohen: A është interes material Panajoti është junior dhe nuk ka rol domethënës në ekipin e angazhimit	Interesi vetiak	Rreziku ndaj pavarësisë nuk është domethënës Nëse do të duhej të eliminohej ky kërcënim, mund të ndrrohet anëtar i ekipit.